



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12164 Prot

Lezhë, më 28/06 /2022

VENDIM

Nr. 63, Datë 28 . 06 .2022

Për një ndryshim në VKB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një ndryshimi në vendimin e KB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2022”, si më poshtë:

1/a- Pakësohet “Plani i investimeve për vitin 2022”, respektivisht në :

-Gr.00, Prog.004520, Kap.05, Art.231 në shumën 22,888,728 lekë, pika 1.a, zëri “Investime në proces nga viti 2019”, pasi këto fonde janë likujduar në fund të vitit 2021,për këto objekte :

-Sistemim, asfaltim rruga para hotel “Letit” me vlerë 5,836,894 lekë.

-Sistemim, asfaltim rruga K.Gjoka-Qendër Ola-Tunel me vlerë 5,409,000 lekë.

-Sistemim, asfaltim blloku në lagjen “Besëlidhja” te DRTT me vlerë 2,569,484 lekë.

-Sistemim, asfaltim oborri para pallatit nr.28, l.”Besëlidhja” me vlerë 2,227,000 lekë.

-Riasfaltim i aksit rrugor Qendër Rrilë-Shkolla 9 vjeçare me vlerë 5,049,000 lekë.

-Ndërtim trotuari dhe ndriçim rruge në fshatin Manati me vlerë 1,391,000 lekë.

-Detyrime të tjera të prapambetura me vlerë 406,350 lekë.

1/b- Shtohet : Gr.00, Prog.06440, Kap.05, Art.602 për shumën 22,888,728 lekë, për likujdim të detyrimeve të prapambetura të krijuara në fund të vitit 2021.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

Në mungesë dhe me autorizim
ZV/KRYETARI
NDUE LULI





Prot 1264/
DT S. 7. 22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

WB

Nr. 451 / 3 Prot.

Lezhë , më 04.07.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijëni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 63, datë 28.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për një ndryshim në VKB nr. 177, datë 23.12.2021, Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

